

## **Udhëzues për Aplikues**

### **MASA PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE**

Ky dokument është përgatitur nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues nga MBPZHR dhe shpërndahet falas.

## Përmbajtja

<b>1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINCIARE PËR KËTË MASË.....</b>	<b>3</b>
1.1 Hyrje .....	3
1.2 Objektivat e masës.....	3
1.3 Mjetet financiare .....	4
1.4 Përkufizimet kyçe .....	4
<b>2. INTENSITETI DHE LARTËSIA E NDIHMËS FINCIARE SI DHE APLIKANTËT e PRANUESHËM .....</b>	<b>5</b>
2.1 Intensiteti i ndihmës.....	5
2.2 Pranueshmëria e aplikantëve dhe aplikacioneve të tyre .....	5
<b>3. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMERISË .....</b>	<b>5</b>
<b>4. KRITERE TJERA TË PRANUESHMERISË .....</b>	<b>7</b>
<b>5. VLERA E INVESTIMIT DHE SHKALLA E PËRKRAHJES FINCIARE .....</b>	<b>8</b>
<b>6. PROCEDURAT E APLIKIMIT .....</b>	<b>8</b>
<b>7. KRITERET E PËRZGJEDHJES.....</b>	<b>9</b>
<b>8. DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I APLIKIMIT .....</b>	<b>10</b>
<b>9. AFATI I IMPLEMENTIMIT .....</b>	<b>10</b>
<b>10. RREGULLAT PËR SHPENZIMET E PRANUESHME.....</b>	<b>10</b>
10.1 Shpenzimet e papranueshme.....	10
<b>11. PROCEDURAT E APLIKIMIT .....</b>	<b>11</b>
11.1 Përmbajtja e aplikacionit .....	11
11.2 Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit.....	12
<b>12. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI .....</b>	<b>12</b>
12.1 Vlerësimet dhe përzgjedhja e aplikacioneve;.....	12
12.2 Kontrollat në teren .....	12
12.3 Radhitja në listë.....	13
<b>13. Procedurat e dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit .....</b>	<b>14</b>
<b>14. Pagesa e Grantit .....</b>	<b>14</b>
14.1 Kontrata mes përfituesit dhe AZHB-së, bashkë me procedurat e prokurimit .....	14
<b>15. DISPOZITA TE RËNDËSISHME QE MUND TË JENË SHKAKTAR I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT</b>	<b>15</b>
<b>16. LISTA E SHTOJCAVE - ANEKSE .....</b>	<b>16</b>
16.1 SHTOJCA 1 LISTA E DOKUMENTEVE TË DORËZUARA.....	16
16.2 SHTOJCA 2: FORMULARI PËR APLIKIM .....	18
16.3 SHTOJCA 3: PROJEKT PROPOZIMI;.....	20
16.4 SHTOJCA 4:Modeli I KONTRATËS.....	20
16.5 SHTOJCA 5: PROCEDURAT E PROKURIMIT.....	24
16.6 SHTOJCA 6: LISTA E INVESTIMEVE/ SHPENZIMEVE TË PRANUESHME .....	26
16.7 SHTOJCA 7: FORMULARI I KËRKESËS PËR PAGESË PËR MASËN UJITJE .....	26
16.8 SHTOJCA 8 : Raporti i Vlerësimit .....	31
16.9 SHTOJCA 9: FORMULARI I INDIKATORËVE.....	31
16.10 SHTOJCA 10: FORMA E ANKESËS .....	32
16.11 SHTOJCA 11: LISTA ME ADRESA TË ZYREVE REGJIONALE DHE KONTAKTET.....	33
16.12 SHTOJCA 12: PROMOVIMI .....	34

## **1. OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINACIARE PËR KËTË MASË**

### **1.1 Hyrje**

Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës, dhe ky zhvillim nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes. Derisa në stinët tjera të rreshurat janë të mjaftueshme, gjatë stinës së verës ato mungojnë. Prandaj imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë. Pendat, rezervoarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat etj. kanë nevojë për rehabilitim, për ndërtime të reja si dhe për mirëmbajtje të rregullt. Zhvillimi i bujqësisë intenzive dhe konkurruese, në kushtet ekonomisë së tregut të lirë, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe parashikimet për të ardhmen.

### **1.2 Objektivat e masës**

Objektivi i kësaj mase është rritja e produktivitetit përmes rritjes së rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore duke përdorur ujitjen e kulturave bujqësore përmes investimeve në:

- Rritja e sipërfaqeve nën ujitje;
- Rehabilitimi i infrastrukturës në sistemet ekzistuese të ujitjes;
- Modernizimi i sistemeve për ujitje, duke zvogëluar humbjet, dhe përdorimin më racional të ujit;
- Përmirësimin e lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes

### 1.3 Mjetet financiare

Për këtë masë për vitin  
2018 janë ndarë gjithsej:  
1.000,000 €

### 1.4 Përkufizimet kyçe

Intensiteti i ndihmës – është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme;

Aplikantë – janë personat fizik ose personat juridik që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të prezantuara në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga grantet e zhvillimit rural;

Aplikacion – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;

Përfitues – personi fizik ose personi juridik i cili është deklaruar përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;

Thirrja për aplikim – njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;

Kontrata – nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikantit të përzgjedhur dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë sipas modelit të përgatitur, shih Shtojcën nr 4

Shpenzimet apo investimet e pranueshme – janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjete publike, shih Shtojcën nr. 6

Periudha e monitorimit Ex-post – periudha kohore prej 5 vjetësh pas përfundimit të investimit, gjatë të cilës përfituesi duhet ruaj qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur dhe ka marrë pikë;

Grant – ndihma financiare e pakthyeshme e dhënë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për shpenzimet e pranueshme;

Autoriteti Menaxhues – entitet publik brenda MBPZHR i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e Programit;

Masa – dokument teknik që paraqet njësinë bazë të Programit dhe pjesët kryesore të saj janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilit synohet të arrihet ndikim i caktuar. Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është Agjencia e Pagesave (<http://azhb-ks.net/>) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2018 – është dokument teknik i cili përcakton masat e zhvillimit rural, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;

Projekt – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikanti;

Periudha e implementimit të projektit – koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri te ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB-ja;

Përzgjedhja – përcaktimi i numrit të pikëve për aplikantët e pranueshëm, radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre „i përzgjedhur për financim“ dhe shpërndarja e mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

## **2. INTENSITETI DHE LARTËSIA E NDIHMËS FINANCIARE SI DHE APLIKANTËT E PRANUESHËM**

### **2.1 Intensiteti i ndihmës**

Ndihma publike është 80 % e shpenzimeve të pranueshme.

**Kujdes:** TVSH-ja është shpenzim i papranueshëm dhe atë e paguan përfituesi! Edhe shpenzimet tjera të papranueshme do të paguhen nga përfituesi.

Çdo tentim për mashtrim (p.sh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa.

### **2.2 Pranueshmëria e aplikantëve dhe aplikacioneve të tyre**

Aplikantët për këtë masë janë:

- Fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Shoqatat e përdoruesve të ujit;
- Kompanit Rajonale të Ujitjes.

## **3. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMERISË**

- Pëlqimi nga kompania publike e ujitjes, në rast se aplikuesi në projektin e tij e parasheh shfrytëzimin e sistemit të ujitjes të kompanive publike;
- Dëshmia që fermerë përfitues nga Masa101 “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore”, janë përfshirë në projekt, nëse ka të tillë;
- Projekte të pranueshme për financim me mjetet publike janë vetëm projektet që pas përfundimit të investimeve janë në funksion të qëllimit për të cilin është bërë investimi (janë në gjendje për të ujitur tokat bujqësore) dhe kjo duhet të dëshmohet me rastin e kontrollës së fundit në terren. Nëse projektet pas përfundimit të investimit nuk janë funksionale, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike të marrë si paradhënie. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i

- mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë pesë vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese;
- Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;
  - Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB;
  - Në rast të projektit të ndërtimit apo rehabilitimit, aplikanti duhet të paraqes edhe: Projektin ideor (teknik) me paramasë dhe parallogari të investimeve;
  - Të gjithë aplikuesit i nënshtrohen kontrollit të pranueshmërisë. Nëse konstatohet se aplikanti është i papranueshëm, aplikacioni refuzohet. Pranueshmëria e aplikantit kontrollohet në bazë të dokumenteve të kërkuara dhe atyre të dorëzuara;
  - Një aplikant mund të dorëzoj vetëm një projekt brenda vitit;
  - Aplikantët duhet të dorëzojnë aplikacionin mbështetur me të gjitha dokumentet e kërkuara - shih Shtojcën nr. 1;
  - Aplikanti duhet të nënshkruaj një deklaratë që deklaron se ai / ajo nuk do të ndryshojë qëllimin e investimit për të paktën pesë vjet pas realizimit të investimit.
  - Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore dhe atë, personat fizik, tatimin në pronë, kurse personat juridik, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme si dhe nuk duhet të kenë obligime finaciare ndaj MBPZHR-së;
  - MBPZHR përkrah me mjete publike vetëm projektet të cilat pas përfundimit të investimeve janë funksionale dhe sjellin përfitim për përfituesin.

**Kujdes:** është e rëndësishme që tatimet të paguhen edhe gjatë zbatimit të Projektit dhe në periudhën e monitorimit Ex-post (5 vjet pas zbatimit të projektit). Përfituesit të cilët do të gjenden me tatime të papaguara gjatë afateve të përmendura, do të jenë të detyruar për ta kthejnë në tërësi vlerën e financuar të përkrahjes publike, si dhe i nënshtrohet ndëshkimeve të parapara me ligj.

#### **4. KRITERE TJERA TË PRANUESHMËRISË**

- Projekti ideor teknik i dorëzuar duhet të demonstrojë zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 20%, në rastet e modernizimit të sistemeve ekzistuese të ujitjes;
- Përfituesi duhet të kontrakttojë kompani ndërtimi me përvojë të mëhershme në ndërtimet e sistemeve të ujitjes dhe ujesjellsave dhe të ngajshme që kërkohen në projekt dhe e cila do të garantojë për punët e ndërtimit për së paku 5 vjet pas finalizimit të punës;
- Kompania e kontraktuar duhet të respektoj Udhëzimin Administrativ për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural 2018, si dhe legjislacionit të prokurimit publik në fuqi;
- Përfituesi duhet të dorëzojë deklaratë me shkrim përmes së cilës garanton se do të participoj me 20% të shumës totale të miratuar për realizimin e projektit;
- Sipërfaqja minimale e projektit nën ujitje duhet të jetë 20 ha;
- Aplikuesit duhet të dëshmojnë të drejtat pronësore të tokës së tyre dhe të gjitha tokave të fermerëve të tjerë ku do të bëhet investimi i propozuar. Kjo nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh. stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, etj.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës, certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon është në trashëgimi të tij;
- Ndërmarrjet e ujitjes dhe shoqatat e përdoruesve të ujitë duhet të dëshmojnë sipërfaqet e ujitura me skicë në rrjetit të ujitjes numrin e fermerve dhe sipërfaqen e ujitjes;
- Në rast të fatkeqësive natyrore duhet të formohet një komision nga AZHB dhe MBPZHR dhe me raportin e komisionit konstatohet se dëmtimi i investimit është bërë si pasojë e fatkeqësisë natyrore. Në këtë rast punëkryesi nuk ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar;
- Përfituesi duhet të dorëzojë deklaratën me shkrim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit;
- Kompanitë rajonale të ujitjes , shoqatat e përdoruesve të ujit ose fermeri si person fizik mund të aplikoj vetëm me një projekt brenda një viti.

**Në rast të projektit të ndërtimit apo rehabilitimit, aplikanti duhet të paraqes edhe:**

- Projektin ideor (teknik) me paramasë dhe parallogari të investimeve.

**Në rast të përzgjedhjes së projektit, para nënshkrimit të kontratës, përfituesi duhet të dorëzojë:**

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i komunës;
- Projektin e detajuar, me paramasë dhe parallogari;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse parashihet me ligj.

## **5. VLERA E INVESTIMIT DHE SHKALLA E PËRKRAHJES FINANCIARE**

**-Vlera minimale e investimeve të pranueshme në kuadër të kësaj mase është 20,000 euro dhe vlera maksimale e investimeve të pranueshme është 200.000 euro**

Në rast se vlera e shpenzimeve të pranueshme është më e madhe se 100,000 €, pagesa bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm. Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për masën Ujitjes së tokave Bujqësore është 600,000 € për përfitues.

Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur.

## **6. PROCEDURAT E APLIKIMIT**

Përmbajta e aplikacionit

Kujdes: për të qenë i pranueshëm aplikacioni duhet të përmbajë të gjitha dokumentet e radhitura në listën e paraqitur në Shtojcën nr. 2

Në rastet kur kërkohen kopje të dokumenteve, dokumentet në origjinal duhet t'u prezantohen zyrtarëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet të shkruajë në kopje këtë tekst: "si në origjinal", dhe ta nënshkruajë.

Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e kopjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që një kopje të dosjes ta ruajë për nevojë personale.

Këshillohen aplikuesit që të aplikojnë së paku 5 ditë para përfundimit të afatit për aplikim, që të kenë mundësi të kompletojnë dokumentacionin e tyre në raste të mungesës së ndonjë dokumenti.



## 7. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Tabela 1. Kriteret e përzgjedhjes për masën e ujitjes së tokave bujqësore

Kriteri	Parametri	Nr. i pikëve
Kostot-efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura dhe rehabilitimin e rrjeteve ekzistuese të ujitjes	Metoda e kalkulimit: Pasi të jenë vlerësuar të gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove për ha, duke filluar nga më e ulëta deri tek më e larta. Projekti me koston më të ulët do të marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për ha do të marrë 0 (zero) pikë. Pjesa tjetër e projekteve të pranueshme do të marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriteri bazë të koston së tyre për ha, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë. Kalkulimi për poentim: $30 * (C_p - \max C) / (\min C - \max C)$ $C_p$ - kosto për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar për ujitje e projektit që vlerësohet. $\min C$ - vlera e shpenzime për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar të ujitjes e projektit me vlerën më të vogël për hektar. $\max C$ - vlera e shpenzime për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar të ujitjes e projektit me vlerën më të madhe për hektar.	Max. 30
Sipërfaqja e ujitur (ha)	≥ 20 - < 50 ha	10
	≥ 50 - < 75 ha	15
	≥ 75 - < 100 ha	20
	≥ 100ha	30
Aplikuesi është anëtar i shoqatës së përdoruesve të ujit për ujitje të tokave bujqësore Kompanit Rajonale të Ujitjes		10
Numri i fermerëve të regjistruar në Regjistrin e Fermës që përfitojnë nga projekti	1 - 10	10
	11 - 20	15
	më shumë se 20	20
Realizimi i projektit përfshinë përfitues të Masës 101 "Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore" në tri vitet e fundit	1 - 5	5
	më shumë se 5	10
Totali		100

**Vërejtje:** Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## **8. DORËZIMI I APLIKACIONEVE DHE AFATI I APLIKIMIT**

**Thirrja për aplikim do të jetë e hapur nga 19/03/2018 deri me 30/04/2018.**

Aplikacionet së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara (shih Shtojcën nr. 1) duhen të dorëzohen brenda periudhës së përmendur në shpallje. Nëse aplikacioni nuk është i kompletuar, ai refuzohet.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyret Regionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

## **9. AFATI I IMPLEMENTIMIT**

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 180 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas periudhës prej 180 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë.

## **10. RREGULLAT PËR SHPENZIMET E PRANUESHME**

Paratë e grantit mund të merren vetëm pasi përfituesi ka realizuar investimin dhe ka paguar faturat në përputhje me aplikacionin e tij dhe kontratën të cilën e ka nënshkruar me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (shih shtojca nr. 6, listën e investimeve të pranueshme).

Shpenzimet janë të pranueshme vetëm nëse ato ndodhin pas nënshkrimit të Kontratës në mes të aplikuesit dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me përjashtim të shpenzimeve administrative, të cilat mund të ndodhin para nënshkrimit të kontratës, por ato u pranohen vetëm aplikuesve të përzgjedhur.

Shpenzimet administrative siç janë: pagesat për arkitekt, inxhinierë, si dhe pagesat për konsultime, për studime fizibiliteti, për vetësim i të drejtave patentore dhe licencave. Shuma maksimale e pranueshme për këto shpenzime nuk duhet të tejkalojë 10% të shpenzimeve të pranueshme, prej të cilave shpenzimet për përgatitjen e projekt-propozimeve dhe planeve të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 3% të shpenzimeve të pranueshme.

Këto shpenzime janë të pranueshme në mënyrë retroaktive vetëm për përfituesit përfundimtarë.

### **10.1 Shpenzimet e papranueshme**

Të papranueshme janë shpenzimet e paraqitura më poshtë:

- Shpenzimet e bëra para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç shpenzimeve administrative;

- Tatimet, përfshirë TVSH-në, përpos për persona fizik dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së;
- Taksat doganore dhe të importit ose ndalesat tjera;
- Blerja, marrja me qira e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
- Shpenzimet operative (shpenzimet për zhvillimin e aktivitetit);
- Pajisjet e përdorura;
- Ndalesat bankare, shpenzimet e garantimit dhe ndalesat e ngjashme;
- Shpenzimet e konvertimit, ndalesat dhe humbjet nga ndërrimi i valutës;
- Kontributet në natyrë;
- Blerja e të drejtave për prodhimtari bujqësore, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- Çfarëdo shpenzimi për mirëmbajtje, zhvlerësim apo qira;
- Çfarëdo shpenzimi nga administrata publike në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës;
- Shpenzimet e sigurimit;

Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre. Për shpenzimet e papranueshme nuk është e nevojshme të respektohen procedurat e prokurimit.

Çdo tentim për mashtrim (psh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

### **Promovimi i përkrahjes**

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në Shtojcën nr. 12. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.

## **11. PROCEDURAT E APLIKIMIT**

### **11.1 Përmbajta e aplikacionit**

Aplikacioni duhet të përmbajë të gjitha dokumentet, të radhitura sipas Listës së dokumenteve të paraqitur në Shtojcën nr. 1. dhe të dorëzohet në afatin për aplikim. Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e kopjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që një kopje të dosjes ta ruajnë për nevoja personale.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm, zyrtari i AZHB-së në Zyre Regjionale nuk e pranon aplikacionin. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i komplotojë dokumentet. **Këshillohen aplikuesit që të aplikojnë së paku 5 ditë para përfundimit të afatit për aplikim, ashtu që të kenë mundësi të komplotojnë dokumentacionin e tyre në rast të mungesës së ndonjë dokumenti.**

Në rastet kur kërkohen kopje të dokumenteve, dokumentet në origjinal duhet t'u prezantohen zyrtarëve të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë. Aplikuesi duhet të shkruajë në kopje këtë tekst: *“si në origjinal”* dhe të nënshkruaj.

## 11.2 Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi do të publikohet në faqen e internetit të MBPZHR: [www.mbpzhr-ks.net](http://www.mbpzhr-ks.net) dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë [www.azhb-ks.net](http://www.azhb-ks.net).

AZHB planifikon që të shpallë thirrjet për aplikim në çerekun e parë të vitit. Ftohen të interesuarit që ta vizitojnë web-faqen e AZHB-së së paku një herë në javë.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyret Rajonale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, (shih shtojcën nr. 11, me adresat e tyre)

## 12. PËRZGJEDHJA, KONTRAKTIMI DHE IMPLEMENTIMI

### 12.1 Vlerësimet dhe përzgjedhja e aplikacioneve;

Procedura e përzgjedhjes do të bazohet në një sistem të renditjes së kriterëve të përzgjedhjes, e cila do të zhvillohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si pjesë e thirrjes publike për aplikim për përzgjedhjen e masës së ujitjes.

Vlerësimi i projekteve dhe kontrollat në teren do të bëhen nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe nga departamenti i PBT së MPBRZH para dhe pas nënshkrimit të kontratës.

### 12.2 Kontrollat në teren

Do të kryhen së paku 3 kontrolle në teren:

1. **Kontrolli i Parë** ( kontrolli para miratimit ),
2. **Kontrolli i Dytë** ( kontrolli pas investimit e para pagesës ),
3. **Ex-post Kontrolli** (Monitorimi) dhe **Superkontrolli**,
4. **Rikontrolli**.

**Kontrolli i Parë** (kontrolli para miratimit), realizohet pas procesit të vlersimit dhe përfshinë

- kontrollin e aseteve të deklaruara në Planin e Biznesit nga aplikues,
- verifikimin e parcelave katastrale,
- verifikimin e pikave kyçe për të cilat është poentuar aplikacioni.

Ç' do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit dhe do të ndikoj në procesin e Miratimit të aplikacionit.

**Kontrolli i Dytë** (kontrolli pas investimit e para pagesës), realizohet pas kryerjes së investimeve sipas kontratës dhe paraqitjes së pakos së kërkesës për pagesë nga përfituesi dhe përfshinë:

- kontrollin e secilit pozicion investues sipas tabës për investimet e parapara, Letrës së Informimit dhe kontratës së nënshkruar,
- verifikimin e cilësisë së investimit,
- verifikimin e realizimit të standardeve minimale nacionale.

Ç' do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit të Dytë dhe do të ndikoj në procesin e Autorizimit të pagesave.

**Ex-post Kontrolli** (Monitorimi), është proces i monitorimit të projektit të bashkfinancuar nga MBPZHR-AZHB dhe përfituesit, sipas obligimeve të marrura me kontratë, për periudhën 5 vjeçare dhe përfshinë:

- verifikimin e të gjitha pozicioneve investuese, dhe
- verifikimin e funksionalitetit të projektit dhe mirmbajtja e investimeve.

Ç' do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Ex-post kontrollit dhe do t'i drejtohet zyrës ligjore për procedim të mëtutjeshëm.

**Superkontrolli** është kontroll i veçant që organizohet me vendim të zyrtarëve siprorë ka ka për qëllim:

- verifikimin e investimeve të kryera në teren,
- pengimin e manipulimeve dhe mashtrimit, dhe
- vlersimin e punës së inspektoratit.

**Rikontrolli** është kontroll që organizohet vetëm në raste të caktuara dhe me kërkesë të drejtorive përkatëse (Drejtorisë së Miratimit të Projekteve dhe Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave).

**Kujdes:** Kur ka kërkesë për kontroll, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në investimet e bëra, kjo vlenë po ashtu edhe nëse kërkohet ndonjë dokument shtesë nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodh mos rrespektimi i këtij kushti duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i grantit dhe ndëshkimi i aplikuesit!

### 12.3 Radhitja në listë

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të radhiten në listë në bazë të pikëve të fituara dhe eventualisht kohës së aplikimit. Përzgjedhja e përfituesve bëhet duke filluar nga aplikuesi me numrin më të madh të pikëve dhe vazhdon deri sa të shpenzohet buxheti i paraparë.

### **13. PROCEDURAT E DHËNIES SË GRANTIT DHE NJOFTIMI I APLIKUESIT**

Pas vlerësimit, AZHB përgatit Raportin e Vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në: 1) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë dhe 2) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë). Raporti preleminar nënshkruhet nga kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet në web-faqe të AZHB-se dhe web faqe të MBPZHR-së. Të pakënaqurit kanë afat 15 ditë nga dita e publikimit që të vijnë në AZHB dhe të informohen për detajet e vlerësimit dhe marrin letrën informuese me sqarimet rreth vlerësimit ose vendimit.

Prej ditës së pranimit të Letrës Informuese, aplikuesi ka afat 15 ditë të ushtrojë ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Ankesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e letrës informuese dhe nëse ka edhe ndonjë dokument tjetër. Komisioni i Ankesave merr vendim brenda 30 ditësh.

Aplikantët e përzgjedhur ftohen të nënshkruajnë kontratën, sipas modelit në shtojcë, me AZHB-në në Prishtinë më së largu 20 ditë pas publikimit të Raportit Përfundimtar të Përzgjedhjes. Të gjitha postimet e rezultateve të vlerësimit në web-faqen e AZHB-së duhet të rrinë aty së paku dy vjet.

**Kujdes: Në rast se përfituesi tërhiqet nga implementimi i projektit pas nënshkrimit të kontratës, ai e humb të drejtën për aplikim në vitin vijues.**

**Përfituesit që pas nënshkrimit të kontratës nuk e implementojnë projektin dhe nuk lajmërohen në AZHB për t'u tërhequr, humbin të drejtën e aplikimit për tri vitet e ardhme.**

### **14. PAGESA E GRANTIT**

Në rast se vlera e shpenzimeve të pranueshme është më e madhe se 100,000 €, pagesa bëhet në dy këste. Pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen përmes transferit bankar.

Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

#### **14.1 Kontrata mes përfituesit dhe AZHB-së, bashkë me procedurat e prokurimit**

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standarde – shih shtojcën nr 4.

Lista e përfituesve që nënshkruajnë kontratë do të publikohet nga AZHB-ja.

Plani i biznesit ose projekt propozimit së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Kontrata mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët (AZHB

dhe përfituesi) deri në përfundim të periudhës monitoruese, që është 5 vjet pas implementimit të projektit.

(Nese brenda periudhes 5 vjecare perfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonje projekti nga MBPZHR, duhet te bëhet nje kontroll para nënshkrimit të kontrates se re me AZHB në menyre që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshëm a është funksional, kjo vjen si rrjedhojë e (Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe përfituesi) deri në përfundimin e periudhës monitoruese që është 5 vjet pas zbatimit të projektit).

Përiudha e përfundimit të projektit nënkupton përfundimin e investimit. Kontrata e mbulon edhe periudhen e monitorimit.

## **Monitorimi Ex-post**

Të gjitha projektet do të monitorohen 5 vite pas Implementimit të Projektit, kontrollimi do të bëhet nga Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 5 vite pas investimit. Gjithashtu, përfituesit duhet të vazhdojnë t'i respektojnë të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhies për të cilat Aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodh shkelja e këtyre rregullave atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet me pagesë.

## **15. DISPOZITA TE RËNDËSISHME QE MUND TË JENË SHKAKTAR I REFUZIMIT TË APLIKACIONIT**

Aplikacionet mund të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara, nese nuk e plotesojnë kriterin e pranueshmerise ose edhe kur e plotesojnë kriterin e pranueshmerise mund të refuzohen për shkak te numrit të vogël të pikëve.

**Kujdes: arsyet e refuzimit duhet të paraqiten dhe sqarohen në letrën informuese të cilën Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ia dërgon aplikuesit.**

- Aplikacionet e pa kompletuara refuzohen në momentin e verifikimit nga zyrtari i AZHB-së me rastin e dorëzimit të tyre. Ne rast se konstatohet më vonë se aplikacioni nuk është i kompletuar, ai poashtu refuzohet.

- Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrolles administrative (psh., mospërputhje me të dhënat apo vlerësime të dokumenteve ose gjatë kontrollës në terren). Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve.

**Kujdes:** për aplikacionet e pakompletuara aplikanti njoftohet menjëherë. Aplikacionet e papranueshme dhe ato të pranueshme por me numër të vogël të pikëve janë pjesë e Raportit të Vlerësimit të cilin Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë publikon në ueb-faqen zyrtare ([www.azhb.ks-gov.net](http://www.azhb.ks-gov.net)) jo më vonë se 24 orë pasi që lista e aplikanteve është e përfunduar dhe nënshkruar nga kryeshefi i Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikantët duhet të njoftohen me shkrim me rezultatin e vlerësimit më së largu pesë ditë pas shpalljes së listës në webfaqe.

## 16. LISTA E SHTOJCAVE - ANEKSE

- Shtojca 1: Lista e dokumenteve të dorëzuara;
